

## NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN, Departamenti i Krimeve të Rënda, në trupin gjykues të përbërë nga gjyqtarët Afrim Shala, kryetar i trupit gjykues, Naser Maliqi dhe Ramiz Azizi, anëtarë të trupit gjykues, me sekretaren juridike Fikrete Destani, në çështjen penale ndaj të akuzuarit I. S., nga fshati B., Komuna e K., për shkak të veprës penale blerja, posedimi, shpërndarje dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge, nga neni 273 paragrafi 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), të cilin sipas autorizimit e mbron avokati Shemsedin Pira, nga Gjilani, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan, PP.I.nr.221/2015, e datës 17 dhjetor 2015, të cilën e përfaqësonte prokurori Agron Uka, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor dhe publik, më datën 14 qershor 2016, mori dhe publikisht shpalli, kurse, më 15 qershor 2016, e përpilojë me shkrim këtë :

## A K T G J Y K I M

Ndaj të akuzuarit I. S., nga babai B. dhe nëna E., e lindur G., i lindur më ..., në fshatin B., Komuna e K., ku edhe jeton, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i papunë, ka të kryer katër vite të shkollës fillore, me gjendje të dobët ekonomike, i martuar, prind i katër fëmijëve,

## REFUZOHET AKUZA

Sepse kinse me datën ... 2015, rreth orës ... minuta, në fshatin B., Komuna e K., me dashje dhe pa autorizim, ka blerë dhe poseduar me qëllim shitje substancë narkotike të llojit "...", e cila me ligj është shpallur si substancë e rrezikshme, në atë mënyrë që gjatë kontrollit dhe bastisjes nga ana e zyrtarëve policor që i është bërë shtëpisë së tij, në dhomën e gjumit, është gjetur dhe sekuestruar sasia prej 3131.1 gram substancë narkotike e cila ka qenë e vendosur në një valixhe dhe e paketuar në 6 qese të plastikes, e përgatitur për shitje dhe shpërndarje tek personat e tjerë, e që bazuar në testin fushor ka rezultuar të jetë "...",

-me këtë kishte për të kryer veprën penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 273 paragrafi 1 të KPRK-së.

Konfiskohet substanca narkotike e llojit "...", në sasi prej 3131.1 gram e cila ka qenë në një valixhe dhe e paketuar në 6 qese të plastikës.

Shpenzimet e procedurës paguhen nga mjetet buxhetore të kësaj Gjykate.

## Arsyetim

Prokuroria Themelore në Gjilan, ka ngritur aktakuzën e lartcekur ndaj të akuzuarit I. S., nga fshati B. Komuna e K., për shkak të veprës penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuare narkotikëve psikotrope dhe analoge nga neni 273 par 1 të KPRK.

Gjatë fjalës përfundimtare, prokurori i shtetit Agron Uka, ka deklaruar se meqenëse gjatë kësaj faze të procedurës nuk është argumentuar me asnjë provë vepra penale e cila i vihet në barrë tani të akuzuarit I. S., për shkak të veprës penale nga neni 273 par 1 të KPRK, andaj, edhe është tërhequr nga akuza ndaj të akuzuarit I. S. nga fshati B., Komuna e K., për shkak të veprës së lartcekur penale.

Andaj, meqë prokurori i shtetit është tërhequr nga akuza pas hapjes së shqyrtimit gjyqësor, trupi gjykues duke u bazuar në nenin 363 paragrafi 1 nën paragrafi 1 të KPP, e refuzoi akuzën PP.I.nr.221/2015, të datës 17 dhjetor 2015.

Vendimi lidhur me konfiskimin e substancës narkotike, është marrë duke u bazuar në nenin 282 paragrafi 1 dhe 2 nënparagrafi 2.4 të KPP, kurse, vendimi lidhur me shpenzimet e procedurës është marrë duke u bazuar në nenin 454 paragrafi 1 të KPP.

Duke u bazuar në këto që u cekën më lart, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

### GJYKATA THEMELORE NË GJILAN

Departamenti i Krimeve të Rënda

Më 15 qershor 2016

Sekretarja juridike,  
Fikrete Destani

Kryetari i trupit gjykues,  
Afrim Shala

**KËSHILLA JURIDIKE** : Kundër këtij aktgjykimi mund të paraqitet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e pranimit të të njëjtit. Ankesa në kopje të mjaftueshme i dorëzohet kësaj Gjykate Themelore.